

LEXMARK
LEGAL

Nese ju duhet një avokat
mos hezitoni te na kontaktoni



Adresa: Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF
Tel:0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



Tel:07435119343
Tel:07494181220
Tel:07379691924




The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 10 TETOR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**“1 NË 50 SHQIPTARË TË BRITANISË
ËSHTË NË BURG”?
SI QËNDRON E VËRTETA E RAPORTEVE
NË MEDIAT ANGLEZE**



PETRIT KUÇANA

**IMAZHI SI
EMERGJENCË
KOMBËTARE**



ARBEN MANAJ

**JOHNSON, BBC “I DJEG”
INTERVISTËN!
GAZETARJA I DËRGOI
GABIMISHT PYETJET PARA
KOHE, GJIGANTI MEDIATIK
ANULON GJITHÇKA**

**HISTORIA E HERSHME E
SANXHAKUT DHE
ARDHJA E SLLAVËVE**

DAUT DAUTI



**“SHTETI SOVRAN I URDRIT
BEKTASHI”, NJË IDE GREKE,
SERBE APO IZRAELITE?**

SHABAN MURATI



**VETËVRASJA
E IRANIT**

BEN BLUSHI




**A KA SHPRESË
PËR NORMALITET?**

LUTFI DERVISHI



**HAPAT E LENINIT
NË TIRANË**

VETON SURROI



**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

1 në 50 shqiptarë të Britanisë është në burg?

A mund të ketë alarm më tronditës, kumbues deri në kupë të

IMAZHI SI EMERGJENCË KOMBËTARE

qiellit, që përcëllon çdolloj hamendësimi për ndonjë gjetje shkaku apo justifikimi, se edhe mund të mos jetë kështu?

Drithërues i pamëshirshëm mbetet ky kryetitull në median britanike, që megjithë "argumentet" se ka shumë më shumë shqiptarë sesa llogaria (mbase 6 herë më shumë se aq) e llogaritë nuk dalin kështu, imazhi për shqiptarët është këputur në mes të shtyllës kurrizore.

Kurrsesi të imunizuar me stërpërsëritjet se shqiptarët zënë vendin e parë ndër kombësitë e burgosura në Britani, vazhdohet si vrazhdë, që duket se nuk po lë asnjë shenjë në ndërgjegjën tonë shoqërore.

A mundëm që të ngritemi ne si shoqeri, mbi retorikën e 'triumfuese' të Shqipërisë turistike dhe realisht të shikojmë realitetin në sy, përtej shkrimeve nëpër median perëndimore dhe më gjerë, të paguara ose jo?

Nëse shikohet bie fjala numri i bimëve të kanabisit që janë korrur në Shqipëri, duket se ky fenomen jo vetëm që nuk mund të marrë fund kurrsesi, por është normalizuar kaq shumë, saqë gati-gati nuk bën lajm, që në krahina të caktuara të vendit, në një dite janë prerë më mijëra rrënjë kanabisi nga policia.

Në më të shumtën e rasteve, mjerisht, në masmedian tonë, paraqitet më tepër si suk-

ses i policisë, edhe pse autorët shpallen në kërkim, ose arrestohet ndonjë mjeran kujdestar.

Dhe kjo vazhdon e vazhdon, si një refren në sinkron të plotë me thënien lapidare kryeministore 'hëngshin kokat e njëritjetrit'.

Prodhim i asaj shoqërie, që duket se është pajtuar me bjerrjen e vlerave, duke ndërtuar një sistem tjetër të pajtueshmërisë me të keqën, së paku, për të mos thënë gati-gati himnizimin e modelit shkatërrimtar se 's'bëjmë transport nënë 100 kile'.

(vijon ne faqe 4)

**AVOKATET E EMIGRACIONIT
PER SHQIPTARET NË UK**

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road. Hounslow, London. TW3 1PA

**L E X M A R K
L E G A L**

Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF



**07435119343
07494181220
07379691924**

**NESE JU DUHET NJË
AVOKAT MOS HEZITONI
TE NA KONTAKTONI**

Individual & Family Visas

- Asylum and Human Rights
- Family and Spouse visa
- European visas
- Student or tier 4 visa
- Visitor visa
- Indefinite leave to remain
- British citizenship

Appeals & Administrator Review

- Immigration Appeals and Review
- Immigration Detention,
- Bail and Removal



Për më shumë informacione në lidhje me procedurat ligjore,
ju lutem kontaktoni ekspertët tanë ligjorë të cilët do t'ju ofrojnë
çdo konsultë ligjore të domosdoshme

Tel: 0208 090 2488 info@lexmarklegal.com

(vijon nga faqe 2)

Kjo krupë prodhon modelin e tmerrshëm të brezi, t që edhe beson se pasurimi i shpejtë, nuk është aq i keq, e madje madje ata tipat arritën deri në parlament, duke sterrosur edhe më shumë ndërgjegjen e një shoqërie, që duket se e ka të pamundur të ngritet mbi zezonën e ububu-shme, për të qëndruar kah vlerat.

Mund të jenë shumë të pakta ditët kur media nuk njofton për shqiptarët e kapur në shtëpitë me kanabis në Britani, por edhe në shtetet e tjera, pa folur për kronikën e zezë për ngjarjet e tmerrshme për heqjet qafe, apo larjen e hesapeve.

A janë shndërruar vërtet në përditshmëri këto lajme?

A kalojnë gati-gati si pa ndjerë, ashtu si lajme të zakonshme, njësoj si disa biseda në bisedat encrochat që zbulohen e bëhen publike herë pas here.

Në ato biseda dëmshohet se ku realisht qëndrojmë si shoqëri, se sa ka depërtuar krimi deri në segmentet më të larta të policisë, apo të politikës, dhe jeta vazhdon krejtësisht e pashqetësueshme, sikur ndonjë film përshtypjet për të cilin mbarojnë aty për aty dhe se nuk ka asnjë pikë kuptimi që të diskutohet të nesërmen, pasi me siguri 'një film tjetër' do të shfaqet dhe mbase edhe



më tronditës, por duket se shoqëria është mësuar, mjerisht, më të keqen. 'Gangs of London' është nga ato filmat që nuk është i vetmi ku protagonizmi kriminal shqiptar shfaqet shtruar krejtësisht tmerrues... e mjerisht nuk është i vetmi.

U kthjem në subjektin e preferuar kriminal të kinematografisë? Pse? Pikëpyetje që duhet të na bjerë kokës çdo ditë...

Çfarë tha ish-zv-kryeministri në arrati? Apo sa futet politika palët ndahen dhe pushteti gjithmonë fiton, duke zeruar çdolloj argumenti, qoftë edhe si thirrje për ndërgjegjësime.

E vazhdohet e vazhdohet derisa në Tiranë shumë nga kolegët tanë në media nuk reshtin së trumpetuar narko-shtetin, por vazhdojnë të mbeten të pafuqishëm përg-

jallë gjithçkasë së mirëkordinuar dukshëm, për shmangjen e cdolloj analize të mirëfilltë, nga e ashtuquajtuara 'aministi fiskale' që eksponentët socialistë e dëshmuar edhe këtu në Londër e deri tek ato gjërat e kapshme se një shtëpi në Tiranë është më e shtrenjtë se një shtëpi në Londër, kur rrogat zor se kalojnë 500 eurot në muaj.

A kemi mundur ne si media të bëjmë de-tyrën tonë?

Kam frikë se jo, dhe fatkeqësisht, nga eksponentët më eminentë të medias në Shqipëri dëgjon për gjobvenie...

Shoqëria civile mjerisht vazhdon të jetë e munguar dhe klasa intelektuale, mbetet aq e pmjaftueshme, deri në kufinj të prekshëm të mos-ekzistencës.

A do të mundet që imazhi shqiptar të jetë një ditë temë diskutimi, qoftë edhe si e tillë, në median shqiptare apo institucionet, që mund të ndriçojnë sadopak mjegulltësinë e ndërgjegjes sonë shoqërore, të bjerruar që përfundimisht ka nevojë për shkundje?

E mbase lajmet për shqiptarët e burgosur në Britani do të fillojnë të rrallohen si dhe ndërtimi i sistemit të ri të vlerave. E kjo do të fillojë sigurisht me trajtimin e imazhit tonë si emergjencë kombëtare.

PETRIT KUÇANA

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk



MY UK
Law ✓

Kërkoni ndihmë ligjore në
gjuhën shqipe?

AVOKATI JUAJ
SHQIPTAR
I LICENCUAR NGA SRA



MY UK
Visas ✓

VISAS
✓

PROPERTY
✓

FAMILY
✓

BUSINESS
✓

NEGLIGENCE
✓

EMPLOYMENT
✓

MyUKLaw është një studio ligjore e drejtuar nga Avokatja shqiptare Arta Heath, e cila ka mbi 23 vite përvojë pune në Angli dhe 14 vite e licencuar nga Autoriteti i Rregullimit të Avokatëve (SRA) në Angli. Studioja ka zyrë në Londër, Sheffield, Huddersfield si dhe një zyrë lidhëse në Tiranë.

Për këshilla në gjuhën shqipe dhe përfaqësim nga juristë me njohuri të ligjeve angleze dhe shqiptare në fushat e sipërme, mund të na kontaktoni.

Na kontaktoni nga e Hëna në të Premte, nga ora 9:00 - 17:30

<u>Huddersfield</u>	<u>Sheffield</u>	<u>London</u>	<u>Tirana</u>
Besmir Mujo	Klodiana Gjonaj	Daniel Buna	Dorotea Celaj
+44 (0) 7861 391147	+44 (0) 7454 819683	+44 (0) 7832 599757	+355 69 659 8957



Për linjën jashtë orarit, kontaktoni +44 (0) 7931 327665 çdo ditë jave pas orës 17:30 deri në 21:30 dhe ditën e shtunë nga ora 09:00 deri në 12:00.



 **reviewsolicitors**
TRUSTED LAW FIRM


"EXCELLENT"
4.8 / 5 STARS | 152 REVIEWS


Ranked
TOP 10%
2024

 Solicitors
Regulation
Authority

ARBEN MANAJ

Është Daily Telegraph e Londres, e njohur si media e së djathtës dhe shumë pranë konservatorëve që humbën zgjedhjet, dhe vazhdimisht e përkushtuar për çështjet ndaj emigracionit shkruan se sipas një analize të kësaj gazete, një në 50 shqiptarë në Britani ndodhet në burg, duke ju referuar tabelës së kriminalitetit nga të huajt.

Mund të këtë një marzh gabimi shkruan Gazeta, pasi shumë të huaj mund të kenë marrë lejen e përhershme të qëndrimit, por nuk kishin aplikuar për pasaport britanike. Shifra e burgimeve për shqiptarët ka qënë 232.23 veta për 10 mije banore ose 1 në 50 shqiptarë.

Kjo e dhënë është përlogaritur bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë në 2021 ku rreth 68 mije e 700 shqiptarë të lindur jashtë Britanisë jetojnë në Britani dhe përjashtoj rreth 16 mijë pa pasaportë britanike, e con shifren në 52 mije shqiptare.

“1 NË 50 SHQIPTARË TË BRITANISË ËSHTË NË BURG”? SI QËNDRON E VËRTETA E RAPORTEVE NË MEDIAT ANGLEZE

Në kushtet kur ka pasur 1227 shqiptarë të burgosur, shkruan Daily Telegraph e Londres, rezulton se 2 për qind e shqiptareve janë në burgje, ose 1 në 50. Po kjo gazete shkruan se kjo analize e vetë gazetës, mund të ketë nënvlerësuar numrat e shqiptareve pasi nuk merr parasysh rreth 12 deri 14 mije që kanë mbritur pas censusit me gomone që e ul në 1 në 100, duke e zmadhuar dyfish problemin real.

Shqiptarët janë në krye të listës të pasuar nga Kosovaret, vietnamezet, algjerianet, xhamakianët, irakianet, somalezet e me e radhe, të cilët kanë ardhur me numra akoma me te medhenj se shqiptaret vitet e fundit.

Faktikisht nuk ka shifra reale të numrit të saktë të shqiptarëve që jetojnë legalisht dhe më e rëndë-



sishmja ilegalisht në Britani, por shifra e censusit padyshim është e pasaktë si pike referimi, dhe shifrat mund të jenë disa fish më shumë.

Qoftë edhe ky fakt e bën të pasaktë pretendimin, pasi nuk bazohet në një shifër reale duke e zmadhuar problemin. Kjo men-

dohet se është pjesë e luftës politike sidomos nga konservatorët e qëndrës së djathtë dhe nuk është hera e parë që shqiptarët bëhen “koke turku”, për politikën sic ka ndodhur kur sundonin konservatorët.

Kjo mendohet se lidhet edhe me luftën për zgjedhjen e udhëheqësit të ri të opozitës ku konkuron edhe vetë ish-Ministri për Emigracionin, Robert Jeneric, i cili ka kërkuar de fundmi që qeveria e re të pakësoj dhënien e vizave për ato vënde nga vinë shumica e kriminelëve të huaj në Britani, në rastin konkret edhe për shqiptarët, edhe pse marrëveshja mes Rames dhe Sunak trumpetohej dhe ende trupemtohet si shembull i luftës kunder emigracionit, që duhet aplikuar me vënde të tjera....



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

**POROSISNI
BANNERIN PER
BIZNESIN TUAJ**

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946

Lëndime Personale

Çfarë ofrojme në?

- Aksidentet ne pune
- Aksidentet me automjete/biçikleta
- Aksidentet jashtë vendit
- Neglizhenca klinike
- Dëmtim truri
- Dëmtimi i shtyllës kurrizore
- Amputimet
- Sëmundja Industriale



BESJANA TOPALLI

Ju mund të bëni një kërkesë për lëndime personale brenda tre viteve nga data e aksidentit ose nga data e diagnozës per sëmundjen tuaj



www.levenes.co.uk/shqiptar/

Jemi të hapur nga e hëna deri të preme nga ora 09:00 deri 17:00



ARBEN MANAJ

JOHNSON, BBC "I DJEG" INTERVISTËN! GAZETARJA I DËRGOI GABIMISHT PYETJET PRA KOHE, GJIGANTI MEDIATIK ANULON GJITHÇKA

"Ajo shton se" duke lënë mënjanë skuqen në fytyrë nga kjo gjë, ndërshmëria është politika më e mirë", shton intervistesja dhe gazetarja më e rëndësishme e politikës së BBC, që drejton shoun politik mjaft të ndjekur të së djelës.

Kjo intervistë me Boris Johnson do ishte intervista e parë në kuadër të disa daljeve televizive për botimin e librit me kujtime të Boris Johnson që botohet në 10 Tetor, të titulluar "Unleashed", ose që argumentueshëm mund të përkthehet si "I çliruar nga xinxhuret".

Pjesë nga këto kujtime tashmë kanë dalë në medianë e shkruar britanike, ku Johnson thotë se ai "nuk është më i sigurt se lockdown-i, gjatë pandemisë ka luajtur ndonjë rol deciziv në mposht-



jen e Covid-it, apo ku ai pretendon, se kishte shqyrtuar kur ishte kryeministër në atë periudhë autorizimin për bastisjen nga forcat britanike të

një depoje në Holandë për të marrë vaksinat e Covidit, duke e pranuar se plani ishte një "gomarllëk i madh". Po ashtu Johnson akuzon

Rishi Sunak se ky i fundit e detyroje të jap fund karrierës së tij politike duke e vrarë njësoj si Brutti, Jul Qezarin.

Vendimi i BBC për të mos intervistuar Boris Johnson, pas dërgimit gabimisht të pyetjeve të intervistes, flet në mënyrë voluminoze për standardin e lartë të parimeve editoriale të gjigantit britanik të medias, pasi e kundërta do ishte njësoj si të luhej domino me gurët e vendosur në tavolinë ku mund të shiheshin numrat.

Është ky standard editorial i BBC, që e bën atë një diamant të çmuar jo vetëm në elitën e simotrave të saj mediatiqe në Britani, por në mbarë botën, duke e vendosur BBC në vendet e para të mediave më të respektuara dhe prestigjioze për objektivitetin dhe paanësinë editoriale, duke i dhënë sërish botës së medias një tjetër shembull të integritetit në raportimin mediatiq. tch

BBC-ja për shkak të gabimit të ish-editores politike, e cila aksidentalisht u dërgoi ish-kryeministrit britanik, Boris Johnson, pyetjet dhe disa shënime për intervistën e planifikuar 30 minutëshe me të, e cila do transmetohej të enjten, ka vendosur bashkarisht me ekipin e Boris Johnson, që të mos e kryej këtë intervistë.

Ka qenë Laura Kuenssberg e cila në platformën X, ish-Twitter, që njoftoj se "nuk ka kuptim të pretendoj se kjo situatë është vecse sikletosëse dhe zhgënjyese, e për pasojë është e drejtë që të mos e bëjmë këtë intervistë.

ESMERALDA TOPI

Gati 45 përqind e auditorëve do të jenë bosh, sot në ditën e parë të këtij viti akademik. Të dhënat e verifikuara nga Faktoje.al dëshmojnë se deri të premtën, 8,775 mijë kuota nga universitetet publike ishin të lira nga 19,212 të miratuara në total.

Në Portalin e Aplikimit Universitar, ku maturanët njihen me kriteret, programet, aplikimin universitar dhe programin ku janë shpallur fitues, rezultojnë se në fund të fazës së dytë të regjistrimeve ka ende mijëra kuota të paplotësuar, teksa ishin regjistruar gjithsej 10,437 studentë.

Por në urimin e ndarë për nisjen e vitit të ri akademik, ministrja e Arsimit Ogerta Manastirliu duket se i referohet kuotave fillestare kur thotë "Suksese mbi 20 mijë studentëve të cilët ulen sot për herë të parë në auditorët e universitetit...", shkruan Manastirliu në profilin e saj zyrtar në facebook.

Degët drejt zhdukjes Shkenca Natyre Mjedisore rezultojnë dega më pak e pëlqyer në Universitetin e Tiranës, me vetëm 2 studentë të regjistruar këtë vit. Më pas vjen Fizika me 5 studentë të regjistruar dhe Kimia me 8.

"Duhet të kishim një emergjencë kombëtare ndërkohë që radhët e mësuesve pakësohen dhe shkollat kërkojnë mësues për të plotësuar nevojat e tyre. Sidomos fizika, matematika dhe gjuha, apo lëndë të tjera bazike janë të paplotësuar. Me këtë trend parashikohet që

UNIVERSITETET, GATI GJYSMA E KUOTAVE ENDE TË LIRA



vitet e ardhshme disa nga këto degë sipas ligjit do të mbyllën nëse për dy vite nuk plotësohen me të paktën 10 studentë.", paralajmëron Rigers Xhemollari nga Qendresa Qytetare.

Nga ana tjetër, një nga degët më të preferuara në Universitetin e Tiranës rezultojnë Informatika Ekonomike, ku vetëm 4 kuota kanë mbetur të lira nga 240 gjithsej.

Të kërkuara vijojnë të jenë edhe inxhinieritë informatike tek Universiteti Politeknik, sikurse arkitektura.

Degët arkitekt, urbanist dhe interieri/dizajn nuk kanë asnjë vend të lirë në këtë fazë regjistrimesh. Ndërsa, inxhinieria e burimeve minerare, ajo gjeologjike dhe gjeomjedisori janë tre degët me më pak regjistrime këtë vit në Universitetin Politeknik.

Universiteti Bujqësor është zgjedhur nga të paktën 638 studentë këtë vit. Degët më të kërkuara janë menaxhim agrobiznesi dhe menaxhim turizmi rural. Ndërsa, në degën inxhinieri agroushqimore ka vetëm 1 të regjistruar. Edhe zooteknia dhe siguria e produkteve blegtorale kanë vetëm 2 regjistrime ndërsa inxhinieria pyjore 5 studentë të regjistruar.

Referuar të dhënave nga U-Albania, këtë vit Universiteti i Mjekësisë vijon të jetë i zgjedhur nga shumica e studentëve. Aktualisht, ky universitet ka vetëm 146 kuota të lira nga 1,624 që kishte gjithsej. Mjekësia e përgjithshme, farmacia dhe stomatologjia nuk kanë asnjë vend të lirë.

Rrethet me rënie drastike Sipas të dhënave nga U-Albania, universitetet e rrethëve vijojnë të shënojnë

rënie drastike studentësh edhe këtë vit. Gjirokastra dhe Korça shënojnë numrin më të ulët të regjistrimeve.

Deri në këtë fazë aplikimesh, në universitetin "Eqerem Çabej" në Gjirokastrë rezultojnë të regjistruar 195 studentë gjithsej, nga 599 kuota fillestare. Aktualisht në këtë universitet numërohen 121 pedagogë- raportoi 1 pedagog për 1.6 studentë.

Degët si menaxhimi i turizmit, historigjeografia dhe matematika kanë vetëm nga 1 studentë të regjistruar.

"Interesi i të rinjve shqiptar për të përzgjedhur degët e mësuesisë është në rënie drastike. Shkoda ka një student për histori dhe dy për gjeografi. Në Elbasan ka vetëm 6 studentë për gjuhë dhe dy studentë të tjerë për mësuesi.", vëren Rigers Xhemollari nga Qendresa Qytetare.

Edhe universiteti "Fan S. Noli" në Korçë rezultojnë me 357 studentë të regjistruar për herë të parë këtë vit. Degët e fizikës, matematikës rezultojnë me nga dy të regjistruar. Ndërsa, infermiera e përgjithshme nuk ka asnjë vend të lirë. Nga 75 kuota gjithsej, aktualisht nuk ka asnjë vend të lirë.

Faktoje.a



PËR SHITJE

Ne nje nga zonat me te frekuentuara ne veri te Londres

I hapur prej 20 vitesh

Me klientele te garantuar perballe nje shkolle

Çmimi shumë i arsyeshëm

Mundesesi fantastike per zhvillimin e biznesit

Për më shumë info tel:
07832 112964



ARMAND SHKULLAKU

Sot ishte një ditë kur ambasada e SHBA dhe ajo BE do të kishin bërë mirë të heshtnin se sa të reagonin për hir të reagimit. Shqetësimi i tyre për ca karrige të djegura në Kuvend, në raport me hedhjen në erë të të gjithë investimit për të ashtuquajturën drejtësi e re, i bën të dukën këto përfaqësi si personazhi proverbial që krihet ndërsa Stambolli digjet.

Ato vazhdojnë të flasin për dialog konstruktiv në një demokraci, që nuk dihet pse e cilësojnë funksionale, për diskutime paqësore e të tjera klishe boshe, ndërkohë që Shqipëria sot është një regjim nën diktatin e një njeriu të vetëm dhe shteti i vetëm në Europë me të burgosur qartësisht politikë.

Nëse selitë e SHBA dhe BE nuk bëzajnë kur SPAK përndjek gazetaret, kur kryeministri përdor si vegla qorre polici, prokurori, gjykatat speciale e atë Kushtetuese për t'i rrëmbyer opozitës mandatin legjitim në Himarë, kur drejtësia e "pavarur" dënon me burg pas 6 vitesh një deputet opozitar, i cili i ktheu Italisë një të dënuar për trafik ndërkombëtar droge, që është dhe vëllai i kryekomisionerit të reformës në drejtësi, atëherë çfarë kanë kaq tronditëse 12 karrige që digjen sa të shqetësojnë dy superfuqitë perëndimore?

Shqetësimi në këtë rast ka të bëjë me faktin se diplomatët e akredituar në Tiranë, duan t'i shohin ato karrige si shkakun e një dhune potenciale në vijim dhe jo si pasojë e dhunimit sistematik që i bëhet opozitës mu përpara syve të tyre. Meqë taksapaguesit

ÇFARË UA KA ZËNË SYTË AMBASADAVE QË SHOHIN VETËM KARRIGET E DJEGURA

perëndimorë kanë paguar për reformën shqiptare të drejtësisë, meqë kjo reformë u është shitur atyre si e suksesshme dhe meqë drejtësi e re dhe narkoshtet i korruptuar nuk qëndrojnë bashkë, përfaqësitë diplomatike në Tiranë nuk janë ndër as kur zgjatja e duarve të pushtetit mbi SPAK, gjykatat speciale dhe deri atë Kushtetuese ka ndodhur hapur ditën për ditë.

Ambasadat nuk kanë folur kur Edi Rama e trajtoi Gjykatën Kushtetuese si peshqir për shezlongët e Olta Xhaçkës. As kur SPAK e çliroi nga akuzat ish ministrin e Shëndetësisë që vazhdonte pa e prishur terezinë me zanatin rilindas të përvetësimit edhe kur bëhej fjalë për fondet e BE. Njësoj edhe kur vetë BE zbuloi batërdinë e abuzimeve me grantet për bujqësinë, askush nga perëndimorët e Tiranës nuk u shqetësua. Dhe nuk flasin as kur kryeministri i bën thirrje hapur drejtësisë të ndjekë e dënojë kundërshtarët e tij politikë. Nëse kjo quhet drejtësi e re dhe demokraci funksionale, atëherë 12 karriget që kanë një problem serioz për të ardhmen euro-atlantike të vendit. Si mund të mos reagojnë kokat e përfaqësive më të fuqishme perëndimore?

Problemi i vetëm është se kur opozita politike burgoset njësoj si në Turqi dhe sytë t'i zë vetëm tymi i protestave që vijnë si rrjedhojë, shqetësimet e reagimet nuk janë mesazh për shqip-



tarët por justifikim për tolerimin e një regjimi që ka degraduar deri në përndjekjen e hapur të kundërshtarëve. Arsyet që arbitri i dikurshëm ndërkombëtar ka hequr dorë nga paanësia, sidomos dekadën e fundit, janë të shumta, por në disa raste të rënda të abuzimeve të pushtetit do të ishte mirë të mos ua kujtonte qytetarëve shqiptarë dështimin e tij. Çfarë efekti mund të kenë tek këta të fundit reagime të tipit që jemi të shqetësuar për dëmtimin e derës së Bashkisë, ndërkohë që brenda dyerve ka ndodhur vjedhja e shekullit nga vetë drejtuesit e Bashkisë.

Nënkryetari i grupit parlamentar të opozitës burgoset për fjalën e lirë, në

një proces të montuar krejtësisht nga pushteti, me dëshmitarë të prodhuar nga policia, vetëm se dërgoi në burg vëllain e ish ministrit të Brendshëm. Shqetësimi i sponsorëve të reformës në drejtësi duhet të ishte në shkallën më të lartë, jo vetëm nga burgosja e një kundërshtari politik, por edhe nga mesazhi që një akt i tillë u përçon banditëve në njërin anë dhe punonjësve të drejtësisë në anën tjetër. Mesazhi se kush është nën shtetullën e pushtetit është i paprekshëm dhe se dënimet politike nuk janë një tabu. Inkurajim për krimin dhe kontroll politik mbi drejtësinë. Mirëpo ambasadat e SHBA dhe BE e panë të arsyeshme të shqetësohen për 12

karriget.

Çështja nuk është se si do të fiket flaka mbi karrige, por pse dhe kush e ndezi atë. Ambasadat sigurisht e dinë, pavarësisht se i shqetëson vetëm pasoja dhe jo shkakun. Për ta kuptuar këtë nuk ka nevojë për ndonjë studim akademik. Mjafton të lexojnë shtypin serioz të vendeve të tyre, i cili pasi bën skanerin e një shteti të kriminalizuar, shpjegon edhe mbylljen e syve nga perëndimi. Para dhe copa Shqipërie për korruptim e lobim në favor të një regjimi që sot ka edhe të burgosurit e tij politikë. Por ama ato 12 karriget janë aq të rënda sa dy fuqitë perëndimore nuk e mbajtën dot peshën dhe më në fund reagues.

ENTON ABILEKAJ

Një spektakël me disa të lënduar, me dëme fasadash, me një fëmijë që provoi për herë të parë gazin lostsjellës, për të kuptuar se ku po jeton dhe me një luftë propagandistike montruoze.

Mbeti një spektakël fishekzjarresh dhe molotovësh, ajo që mbrëmë u pretendua të ishte fillimi i mosbindjes civile. Një spektakël me disa të lënduar, me dëme fasadash, me një fëmijë që provoi për herë të parë gazin lostsjellës, për të kuptuar se ku po jeton dhe me një luftë propagandistike montruoze.

Kulmi i propagandës ishte rasti i gruas që lindi në makinë. Pasi lajmëroi urgjencën, në vend të ambulancës i shkuan kamerat për të prodhuar filmin e fundit të Rilindjes, protesta detyron nënën të lindë në makinë. Me mjekët e ardhur serbes nga spitali që ishte aq afër sa, po të mos kishte dhimbjet e lindjes, mund ta bënte në këmbë, videoja u përhap si virus në të gjitha mediat. Propaganda arriti kulmin e suksesit, ndërsa shërbimi shëndetësor kulmin e turpit.

Pastaj Ministri i Brendshëm doli për të share opozitën, duke treguar se është aty si komandant i një trupe të armatosur në mbrojtje të Regjimit dhe jo për tu shërbyer qytetarëve, policë apo protestues qofshin. Drejtuesit e PD-së që drejtuan protestën u paditën në Prokurori, duke plotësuar kështu ansamblin e liderëve të opozitës me çështje penale.

E gjitha ajo që ndodhi shpjegon vetveten, një opozitë pothuajse e pafuqishme, përballë një pushteti absolut dhe agresiv, që pasi ka kapur gjithçka, nuk e ka fare problem të burgosë edhe opozitën.

Sot ishte qetësi, sikur kjo fabul të mos kishte ndodhur vetëm pak orë më parë, sikur pushteti i korruptuar që ka korruptuar gjithçka të mos jetë më aty, sikur rezistenca ndaj së keqes të jetë vetëm detyrë e një partie. Por as partia nuk e bën dot më. Pas shfaqjes

“MOSBINDJA” - SPEKTAKLI QË U SHUA, PËRBALLË DHUNËS QË VAZHDON



së mbrëmshme, sot në vend të intensifikimit të aksionit, kishte shpërndarje dekoratash. Rezistenca kthehet si spektakël i organizuar nga zyra e organizimit, në një datë të papërcak-

tuar. Një shoqëri e lodhur që ka nxjerrë një opozitë po aq të lodhur nga një pushtet totalitar që dhunon çdo ditë. Edhe e anasjellta është po aq e vërtetë, një opozitë e lodhur, që nuk


di të ndezë asnjë shkëndijë në një shoqëri të asfikusuar.

Kështu pushteti dhe dhuna e tij mund të ndihen që sot më të inkurajuar për tu bërë akoma më totalitar, më të paligjshëm, më kontrollues dhe më të pakujdesshëm për të fshehur krimin.

Ndërsa opozita, ashtu e konsumuar dhe e akomoduar mirë si fasadë, mund të bëhet e dobishme vetëm kur të fillojë komunikimin me qytetarët, vetëm kur të ndajë hallin e rotacionit nga ai i zgjedhjeve të lira, endrran e pushtetit të ardhëm nga brutaliteti i pushtetit të tanishëm. Kur në vend të sekreteve qesharake, të zgjedhë transparencën dhe ndërveprimin me qytetarët, që ata të gjejnë më në fund veten tek arsyet për “moshindje civile”. Nëse do të jetë ekskluziviteti i PD-së, moshindja do të mbetet një spektakël i kufizuar, me orarin e caktuar nga një punonjës partie që ka marrë leje në polici për të ngritur kokën.

**FOR
SALE**

**Coffee Shop For SALE NEAR WOOD
GREEN TRAIN STATION**



Coffee Shop PËR SHITJE

Good selling price

I hapur prej vitesh
Me klientele te garantuar
Mundesit fantastike per zhvillimin
e biznesit
Afer stacionit te trenit
ne Wood Green

Contact Us Whatsapp

07702576611



REASONABLE PRICE



REASONABLE PRICE



07702576611

DAUT DAUTI

“The Sandzak – a history”, është me siguri libri i vetëm dhe më i miri që është botuar në anglisht dhe në gjuhë tjera për Sanxhakun. Si i tillë, ky libër është histori për boshnjakët, shqiptarët, serbët dhe tërë Ballkanin. Më poshtë keni një përkthim nga kapitulli i parë i këtij libri:

Historia e hershme e Sanxhakut dhe ardhja e sllavëve

Shenjat më të hershme të banimit të Sanxhakut janë gjetur në shpellën e Smolučkës në komunën e Tutinit, që tashti është pjesë e Sanxhakut të Serbisë e që datojnë nga koha e Paleolitit. Në vende tjera arkeologët kanë zbuluar dëshmi të komuniteteve njerëzore që datojnë nga periudha e Lartë e Paleolitit, përafërsisht 20 000 vite p.e.s. dhe duke vazhduar në Mezolit (vitet 10 000 p.e.s.), që janë gjetur në Medena Stijena (Shkëmbi i Mjalltit) në kanionin e Çehotinës dhe në disa vende tjera afër Plevles në Malin e Zi të sotshëm.

Para 3000 viteve një popull i njohur me emrin dardanët, që ishin pjesë e grupit të fiseve të ilirëve apo thrakasëve, u vendosën në rrafshnaltën e Sjenicës dhe në rajonin përreth. Gjurmë të kulturës së tyre të Brnjicës (varrime me djegjeje të kufomave) ende mund të identifikohen nga shek. VIII p.e.s. afër Sjenicës dhe



më gjerësisht në luginën e lumenjëve të Rashkës, Ibrit dhe Sitnicës.

Rreth mileniumit të parë p. e. s. grupe të ndryshme të ilirëve e zhvilluan një gjuhë dhe kulturë të përbashkët, e cila e mbulonte rajonin që sot është Bosna jug-lindore, Serbia jug-perëndimore, gjysma e pjesës veriore të Shqipërisë

dhe Malit të Zi duke u zgjeruar deri në Epir dhe në Maqedoninë veriperëndimore. Mbetjet e shumë kështjellave të vogla në rrënjët e kodrave të shpërndara nëpër rajon, tregojnë se ka ekzistuar një kulturë luftarake që është zbatuar nga udhëheqësit fisnorë lokalë ku banorët shpesh janë de-

HISTORIA E HERSHME E SANXHAKUT DHE ARDHJA E SLLAVËVE

tyruar të kërkojnë mbrojtje nga njeri tjetri në këto vendbanime të fortifikuara.

Mes shekujve VI dhe IV p.e.s. anëtarë të një fisi tjetër ilir, autariatët, u vendosën në luginën e Rashkës dhe në rrafshnaltën e Peshterit, me gjasë duke i larguar kah jugu dardanët e mëhershëm. Hulumentimet e bëra në ato që duket se janë varreza të luftëtarëve autariatë në Glogovnik (Mal të Zi), sugjerojnë se ky grup formon një pjesë integrale të kulturës Glasinac, e cila gjatë Epokës së Hershme të Hekurit (shek. VIII – V, p.e.s.) është zgjeruar në një rajon që ka përfshirë Bosnën lindore, jugperëndimin e Serbisë, pjesë të Malit të Zi dhe Shqipërinë veriore. Afër Novi Pazarit, arkeologët kanë lokalizuar një ekzemplar të kulturës Glasinac që gjendet në themelet e kishës së shek. IX, që quhet Petrova Crkva. Një varr, që mendohet se është i një luftëtari fisnik nga shek. VI p.e.s., është gjetur i pajisur me ari, argjend, stoli bronzi, maska çelibri, statuja të çeramikës, përfshirë figurat e zeza të enëve greke, që sugjerojnë se popullata vendase e kësaj kohe ishte në kontakt me Greqinë.

Tentimi i Justinianit për të rivënë qetësi dhe rindërtuar perandorinë, mezi mbijetoi gjatë jetës së tij pasi që kah mesi i shek. VI, dhe përsëri në fillim të shek. VII, Ballkani edhe një herë u përfshi nga valët e invaduesëve. Këta ishin sllavët që filluan të migronin nga atdheu i tyre, diku në Ukrainën e sotme, në rajonet e largëta të Danubit. Serbët, të shoqëruar nga avarët turkik, që ishin më luftarak, vazhduan të kërcënonin Konstantinopolin. Nën presionin e persianëve dhe për shkak të trazirave të brendshme, Perandoria Bizantine u detyrua të hiqte dorë nga posedimet perandorake në brendësinë e siujdhesës ballkanike.

Sllavët, përkundër avarëve, kishin ardhur për t'u vendosur e jo vetëm për të plaçkitur. Prandaj, u vendosën përgjatë rrugëve tranzitore romake dhe i okupuan rajonet e plleshme të luginave të lumenjëve. Pa mbrojtjen e bizantinëve dhe duke mos qenë në gjendje të mbrohen vetë, popullata vendase u strehua në rajonet e largëta malore ku u morën me mënyrën e jetës pastorale dhe që e folnin gjuhën e tyre që ishte një variant i latinishtes.

Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut shfuqizoi të mërkurën atë që njihet si “balancues”, një instrument për përfaqësimin e drejtë sipas përkatësisë etnike të kandidatëve për nëpunës në administratën shtetërore.

Gjykata para dy javësh e vuri në shqyrtim çështjen, ndërsa debate të shumta u nxitën në opinionin publik të vendit.

Gjykata konstaton se “deklarimi i përkatësisë etnike në konkurset për vende pune është i jashtëligjshëm dhe diskriminues dhe se mekanizmi i njohur si ‘balancues’ shkel parimin e ekspertizës dhe aftësisë së kandidatit duke cënuar edhe të drejtën e garantuar kushtetuese për punë dhe zgjedhjen e lirë të punësimit”.

Sipas kreut të Gjykatës Kushtetuese, Darko Kostadinovski, “motivi për shfuqizimin nuk është fare politik edhe atij as nuk i intereson se çfarë komentojnë partitë politike”.

Në një konferencë shtypi ai u bëri thirrje partive që t'i respektojnë vendimet e gjykatës dhe “të mos i politizojnë apo t'i përdorin për qëllime etnike”, siç u shpreh.

“Është absurde të thuhet se Gjykata Kushtetuese dëshiron destabilizimin e vendit. Kjo është një gjë e padëgjuar dhe manipulim klasik”, tha zoti Kostadinovski në përgjigje të akuzave që i drejtohen atij nga partitë e opozitës.

Shfuqizimi i “balancuesit” ishte paralajmëruar gjatë fushatës zgjedhore nga VMRO-DPMNE-ja, e cila i fitoi

KRYETARI I GJYKATËS KUSHTETUESE: INSTRUMENTI PËR PËRFAQËSIMIN ETNIK NË ADMINISTRATË ISHTE KUNDËRKUSHTETUES



zgjedhjet e 8 majit dhe formoi qeverinë.

Nga data 18 shtator Gjykata urdhëroi ndalimin e zbatimit të këtij instrumenti, ndërkohë që vendimi nuk do të ketë pasoja për personat të cilët janë punësuar prej vitesh në administratë në bazë të këtij mekanizmi.

Nisma për “balancuesin” u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese nga administrata e kaluar e Komisionit Shtetëror

për Luftën Kundër Korrupsionit. Por gjykata e mbajti atë në sirtarë për vite të tëra.

Gjykata kushtetuese ka nëntë anëtarë, prej tyre gjashtë maqedonas, dy shqiptarë dhe një turk. Anëtarët e komuniteteve jomaqedonase nuk e kanë miratuar vendimin për shfuqizimin, ndërsa një nga ta nuk ka marrë pjesë në seancë.

Aleanca për Shqiptarët (ASH) e krahut të Ziadin Selës kërkon që

gjykata të vendosë me parimin e “Badenterit” apo me “shumicë të dyfishtë”; me shumicë të kualifikuar për ato ligje të cilat Parlamenti i ka miratuar po në këtë mënyrë.

Opozita shqiptare e drejtuar nga Bashkimi Demokratik për Integritet thotë se vendimet e gjykatës bien ndesh me Marrëveshjen e Ohrit; se këto çështje janë zgjidhur në të kaluarën dhe “çdo përpjekje për kthim prapa në të kaluarën do të ketë pasoja dhe pakënaqësi të qytetarëve”.

BDI thekson se “ky është fillimi i shkatërrimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe i themeleve të Marrëveshjes së Ohrit”.

ASH-ja, ndërkohë vendimin e së mërkurës e shikon si një konfirmim “të politikave anti-shqiptare të qeverisë jolegjitime” dhe pozitës “vasale” të partive të koalicionit VLEN në të. Ndërkohë, partitë shqiptare në pushtet thonë se po bëjnë gati një ligj të ri për përfaqësimin e drejtë dhe se brenda një të ardhmeje të afërt do ta dorëzojnë në parlament.

Përfaqësimi i drejtë i pjesëtarëve të komuniteteve buron nga Marrëveshja e Ohrit që i dha fund konfliktit mes qeveritësve shqiptarë dhe forcave qeveritare maqedonase në vitin 2001

dhe solli paqen në ish-republikën jugosllave.

Numri i papërfillshëm deri atëherë i shqiptarëve në administratën publike dhe agjencitë shtetërore u shumëfishua në vitet në vijim dhe tani vlerësohet të ketë arritur në rreth njëzet përqind.

Gjykata Kushtetuese, po ashtu pritet brenda pak javësh ta shqyrtojë kushtetutshmrinë e Ligjit për Gjuhët. Ky ligj ka avancuar përdorimin e gjuhës shqipe deri në nivelin e gjuhës së dytë zyrtare në shumë rajone të Maqedonisë së Veriut.

Por, partitë e pushtetit të kaluar të cilat e miratuan atë e dërguan ligjin në Komisionin e Venecias me shpresë se do të merrnin miratim, ndërsa nga atje këshilluan se ligji, ose dygjuhësia është vështirë të zbatohet sidomos në gjykata dhe procedurat gjyqësore.

Procedurat gjyqësore nuk mbahen në gjuhën shqipe, përveç mundësisë që pala e akuzuar të flasë në gjuhën shqipe, nëse kërkon dhe as uniformat e policisë dhe ushtrisë nuk kanë shenja edhe në gjuhën shqipe, siç parashikon ligji.

(Zëri i Amerikës)

ANDI BUSHATI

Opozita nuk i'a ka dalë dot, në ciklin e katërt të protestave, atë për t'u afirmuar përmes dhunës. Të hënën e 7 tetorit, PD vërtet arriti ti vërë flakën portretit të Edi Ramës mbi fasadën e PS-së, vërtet i mbushi me tym, flakë e gaz lotësjellës të gjitha institucionet kryesore të qeverisjes, por ajo nuk që në gjendje të shkojë përtej simbolikës.

Në këtë kuptim, duke u krahasuar me tre ciklet e mëparshme të periudhës së rifillimit të protestave, që rinisën në vitin 2022 (pas një tredhje gati tre vjeçare të epokës Basha), kjo e tanishmja mund të konsiderohet një dëshitim.

Kur në 7 korrik 2022 Berisha u bëri thirrje të vetëve të derdeshin në rrugë, demokratët të përmalluar për atë çka dinë të bëjnë më mirë i'u përgjigjën në mënyrë impresionuese. Në atë kohë, kur simbolet, vulën dhe përfqësimin e partisë, pushteti këmbëngulte ti'a falte dyshes Basha – Alibeaj, kjo lëvizje u konsiderua si një sukses. Qëllimi ishte të krijonte përshtypjen në publik se Rithemelimi ishte PD-ja e vërtetë. Ajo përgjigje e militantëve e përforcoi këtë bindje.

Gjithashtu të suksesshme mund të konsiderohen edhe mitingjet e organizuara për ti treguar ndërkombe-tarëve se ky vend nuk ishte ai që ata u përshkruajnë shqiptarëve. Qoftë në protestën e 6 dhjetorit 2022, atë që zhvillua njëkohësisht me samitin e kryeministrave të BE dhe Ballkanit perendimor në Tiranë, ku një dorë e padukshme, e nxitur në rastin më të mirë nga gjuha e urrejtjes, goditi mbi Sali Berishën, apo qoftë edhe në demonstrimin e 20 shkurtit, pesë ditë pas vizitës së Sekretarit Blinken në Tiranë, që i thuri ditirambe Edi Ramës, njërëziti u derdhën të shumtë në shesh.

Edhe ai që mund të konsiderohet si cikli i tretë, që celebri në 11 korrik



të këtij viti, bashkimin përfundimtar të PD duke kaluar pothuajse të gjithë deputetët në grupin ku qëndronin tashmë votuesit e militantët i'a arriti qëllimit. Pas një kalvari të gjatë, PD-ja e unifikuar ishte në të drejtën e saj të festonte, një muaj pas rifitimit në gjykatë të vulës, siglës, flamurit që i përkisnin.

Por të treja këto lloje protestash, pavarësisht nga diversiteti i temave, kishin si fill të përbashkët afirmimin. Ato herë kërkonin të dëshmonin se kush që shumica në opozitë, herë se në këtë vend ka një masë kompakte anti qeveritare, herë se drejtimi i marrë, qoftë edhe me përkrahje ndërkombe-tare, nuk që ai i duhuri dhe për ta arritur këtë, mjaftonte prezenca e një mase serioze pjesmarrësish. Në ciklin e katërt, atë që nisi këtë 7 tetor,

sfida që e ndryshme: ajo nuk kishte të bënte më me afirmimin, por me kundërshtimin përmes forcës. Pasi ishte dëshmuar si opozita e vetme e madhe në vend, pasi ishte konfirmuar me afro gjysëm milioni vota, PD kërkonte të respektohej si e tillë.

Por në vend të kësaj, ajo u përball me burgosje politike si procesi ndaj Salianjit, me rëmbim të mandatesh të humbura falë SPAK-ut dhe GJKKO, si në rastin e Himarës, me përdhosje të kushtetutës si për mandatin e Olta Xhaçës e me plot të drejta të tjera të nëpërkëmbura, si pengimi për të ngritur komisione hetimore, për të zhvilluar interpelanca apo mocione në kuvend. Dhe kur diçka që të takon ligjërisht ta rrëmbejnë padrejtësisht, nuk mbetet rrugë tjetër drejt forcës. Nuk ishte PD që zgjodhi të shkante

tek molotovi, ishte sjellja ndaj saj që i'a imponoi atë si rrugë të vetme.

Por pikërisht këtu, kur tentoi rrugën e forcës, ajo dështoi dhe kjo e ka një shpjegim. Boll që për këtë të bësh një krahasim të thjeshtë, mes protestës së organizuar nga opozita e Ramës në janar 2011 dhe kësaj të tanishmes. Dikur PS në opozitë kishte milionerët e saj që derdhnin shumë para të domosdoshme për organizimin e ndërmarrjeve të tilla. Ajo kishte në dispozicion, për më tepër edhe bandat kriminale, që siguruan kontigjentet që u përleshën me policinë dhe e zbrapsën atë në përballjen përpara kryeministrisë. Opozita e sotme është shumë më e dobët. Ashtu siç ka futur në kontroll, institucionet e pavarura, prokuroritë, gjykatat apo televizionet kombëtarë, PS ka dominimin e plotë

edhe mbi oligarkët si financuesë dhe bandat kriminale si ekzekutuesë evenimentetsh të tilla. Shprehja e dikurshme e Berishës, se e rrëzon qeverinë vetëm me demokratët e Laçit dhe Mamurrasit, tani duket si utopi. I tillë është dhe cikli i protestës opozitare që sapo filloi, ai për t'u afirmuar përmes forcës. Prandaj dhe ndryshe nga të parët ai dështoi. Sepse ky regjim ka asfiksuar gjithçka duke shndërruar në mision të pamundur edhe sfidimin përmes dhunës, njësoj si atë përmes votës. I vetmi ngushëlim për PD-në mund të jetë se ajo nuk është humbësja e vetme e kësaj gjendje. Të tillë janë një pjesë e madhe e shqiptarëve të cilët janë zhveshur nga mundësia për të jetuar në një sistem të barabartë dhe me ekuilibër forcash.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



LUTFI DERVISHI

Pyetja mund të merret si akuzë, si reflektim realiteti, mund të jetë lutje, por mund të jetë edhe retorike?

Djegia e karriqeve nga deputetët e opozitës, para godinës së Kuvendit në shenjë proteste ndaj burgosjes së një kolegu, do të pasohet nga protesta e paralajmëruar e 7 tetorit që me shumë gjasë nuk do t'i ngjajë protestave të tjera. Pas zjarrit vijnë gjithnjë pasoja.

Opozita po rrekej me javë dhe muaj për një "protestë të madhe". Nuk po ndezte.

Pas verës së nxehtë, vendi dukej se po futej në shinat e normalitet.

Kryeministri që kishte injoruar një sërë interpelancash iu përgjigj kërkesës së deputetëve të opozitës dhe ngjarja më e madhe dukej se do të ishte shpallja e datës së zgjedhjeve të ardhshme.

Dhurata opozitës i erdhi nga vetë pozita. Njëherë duke refuzuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për një deputet të vetin dhe herën e dytë nga gjykata e Apelit që mori një vendim jo vetëm të diskutueshëm, duke dënuar nënkryetarin e grupit parlamentar të PD-së.

Gjykatësit dhe prokurori duke shkruar "kallëzim i rremë publik" bënë vetë një kualifikim veprë penale që nuk e ka as kodi penal, as ai i procedurës penale

(Parimi themelor që u mesohet studentëve në fakultet juridik dhe në shkollën e magistratures: sine lege nulla poena (nuk ka denim për diçka që nuk parashikohet në ligj))

Për me tepër dënimi u dha jo me gjobë, jo me 6 muaj heqje lirie, por 1 vit burg që deputetit jo vetëm t'i hiqej mandati, por të vuajë edhe 5 vjet sipas ligjit të dekriminalizimit. Qershia mbi tortë në këtë rat është gëzimi i papërmbytur i Kryeministrit që u shpreh nga Nju Jorku përmes platformës X.

Shprehja "idiote" nuk komentojmë vendimet e gjykatave tani mund të lexohet: nuk komentojmë, por i gëzohemi dhe i përgëzojmë.

Vendimet e gjykatave në një vend normal, zbatohen, por komentohen që ç'ke me të. Debatit dhe teprimi në lirinë e shprehjes është çmimi që një shoqëri pagan për të qenë e lirë.

Në një vend normal, ku gjykata nuk është zgjatje e tekave politike, kjo çështje nuk do të ishte çështje. Por ne pëlqejmë tragjikomedinë jo vetëm në politikë, por edhe në Drejtësi.

24 deputetë të opozitës janë dërguar në SPAK për djegien e karriqeve! Në kundërpërgjigje 73 deputetë të shumicës janë paditur nga opozita në SPAK për mos zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.



Në një vend normal, SPAK duhet të ishte lënë i lirë sepse vetëm me përgjimet e bisedave në SKY dhe Encrochat ka shumë punë për të bërë, duke nisur nga vettingu i vetes, për të vijuar me shumëkëndëshin Krim-politikë- biznes- media- drejtësi. Duket se i vetmi vetting që nuk mund të ndikohet nga politika dhe krimi mund të jetë zbardhja dhe hetimi i komunikimeve në këto aplikacione, ku përveç të tjerëve edhe prokurorë e gjykatës marrin e japin me botën e nëndheshme.

Në një vend normal, Parlamenti, teorikisht djepi i debatit demokratik, nuk do të ishte teatër ku gjatë gjithë kohës aktorët janë në podium, duke hedhur kush propagandë e kush akuza.

Në një vend normal deputetët angazhohen në një dialog të vërtetë dhe kuptimplotë.

Në një vend normal, etika parlamentare nuk është thjesht një formalitet, por një udhëzues që respektohet nga të gjithë. Opozita dhe qeveria përballen në sallë, por konflikti mbetet brenda sferës së ideve. Këtu, preferohet një lloj tjetër drame, ku paditë fluturojnë si avionë letre, dhe etika ka aq forcë sa urdhëri i ofi-

cerit ndaj ushtarit ditën e fundit të ushtrisë.

Media si marionetë për manipulim Në një vend normal, media raporton mbi çështjet, heton keqërbretet dhe mban pushtetin përgjegjës. Në një vend anormal media shfaqet si krah i qeverisë, ministrat kthehen në reporterë që raportojnë vetveten duke shpërndarë me gaz e hare propagandën e veshur si lajm.

Në një vend anormal në lajme nuk sheh njerëz, por ministra, nuk sheh halle, por vetëm gaz e hare, nuk sheh njerëz që largohen, por vetëm turistë që vijnë, nuk sheh ngjarje, por protokoll, nuk sheh denoncime, por vetëm lavdërime, nuk sheh vepra, por zotime, nuk sheh mosrealizme, por inspektime.

Iluzioni i Transparencës Ne flasim për transparencën si instrumet magjik që mjafton ta shqiptojmë dhe do të pastrojë sistemin dhe aktorët nga të gjitha mëkatet. E megjithatë, transparenca është më shumë një iluzion, një mirazh që zhduket sapo mendon se ke kapur një pamje të saj. Vendimet merren në dhoma të mbushura me tymin e puros, dhe ligjet gatohen për t'i shërbyer interesave të një grushti njerëzish. Kemi

mbërritur në pikën ku zyrtarët më parë dorëzojnë duart të Prokurori se të japin informacionin dhe dokumentat që e kanë detyrim ligjor për t'i dhënë.

Një vend normal është ai ku institucionet janë më të forta se liderët që i zënë përkohësisht dhe jo ai ku institucionet përkulen sipas vullnetit të liderit.

Korrupsioni nuk është thjesht një fenomen që e has kudo; është një mekanizëm plotësisht funksional që drejton sistemin, i vajisur me sloganin "kemi SPAK-un për këtë punë!" A thua se ekzistenca e vetëm një institucioni i shfaqëson të gjithë të tjerët nga përgjegjësia! Vullneti politik sa vjen dhe i ngjan legjendës që shumë flasin për të, por askush nuk e ka parë.

Në thelbin e anormalitetit është e vërteta e hidhur që ne nuk po flasim për problemet e vërteta. Në një vend normal, diskursi politik do të përqendrohej te politikat e orientuara drejt së ardhmes, në zgjidhjen e problemeve reale si varfëria, papunësia, shëndetësia, pensionet, largimi i njerëzve dhe jo te trushpëlarja e propaganda.

Zgjedhjet si iluzion demokratik

Në një vend normal, zgjedhjet janë të lira, të ndershme dhe një reflektim i vullnetit të votueve. Në një vend anormal, zgjedhjet kthehen në një treg ku paratë, ndikimi dhe fuqia e kriminit të organizuar paracaktojnë rezultatin. Nga një garë me rregulla të qarta dhe kushte të barabarta mes partive garuese, zgjedhjet kthehen në një luftë të pushtetit me opozitën.


A mund të jemi vend normal?

Por para përgjigje se kësaj pyetje duhet adresuar pyetja: çfarë nënkuptojmë me vend "normal"? Nëse normal do të thotë një demokraci funksionale, e lirë nga ndikimet toksike të korrupsionit, manipulimit mediatic dhe hakmarrjeve personale, atëherë kemi ende një rrugë të gjatë për të bërë.

Por ndoshta duhet të qartësohemi se çfarë vendi duam që të jemi. Për momentin jemi në rrugën e një cikli dystopik dhe nëse nuk dalim prej tij, normaliteti do të jetë fantazi dhe anormaliteti normalitet.



Bella Diana Aesthetics Clinic

- Lip  filler
- Fat Desolving
- Microneedling
- Anti wrinkles botox
- ~~~~~
- Skin booster
- B12
- Double chin
- Under eye treatment
- ~~~~~
- Vitamins treatment
- Hair restoration
- PRP
- Exosome therapy
- Acne
- Dark spots
- Redness
- Anti aging
- Under arms Botox
- Skin booster



 **07949 182688**
180 FINCHLEY RD,
LONDON, NW3 6BP

SHABAN MURATI

Disa analistë të vjetër dhe të respektuar e pritën me ironi, tallje dhe sarkazëm projektin grandioz planetar të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për krijimin e një "shteti sovran të Urdhrit Bektashi" në territorin e Shqipërisë. Nuk u kuptua se kemi të bëjmë me një projekt të paparë panbotëror dhe kryeministri, jo rastësisht, zgjodhi për të njoftuar botën për projektin zëdhënës botërore prestigjioz amerikan "Nju Jork Tajms" në 21 shtator 2024 dhe tribunën më të lartë diplomatike të OKB-sënë 22 shtator 2024.

Nuk begenisi t'ia thoshte më parë as opinionit publik shqiptar, as popullit shqiptar, as Parlamentit shqiptar dhe as Partisë së tij Socialiste Internacionale. Natyrisht nuk begenisi dhe e shkeli me dy këmbët Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, që e ndalon të shkëpusë territore të shtetit dhe të krijojë mikroshtete. Kryeministri donte të trondiste botën me projektin e tij të paparë dhe kjo botë, që nuk dëgjon as Papën e Romës dhe Vatikanin, as Patriarkun botëror ortodoks Bartolomeu, as Kryemyftiun e Turqisë apo të Arabisë Saudite, do të detyrohet tani të dëgjojë mikroshtetin e Urdhrit Bektashian, që po e pjell për botën globale lideri global Rama në mes të Tiranës.

Kryeministri e di se Kryegjyshitën si përfaqësuese e një pakice fetare nuk e dëgjojnë as në Shqipëri, as në Kosovë dhe as në Maqedoninë e Veriut apo në Luginën e Preshevës. Kryeministri e krijon në mes të Tiranës, jo që mikroshtetin bektashian ta dëgjojnë shqiptarët, por që ta dëgjojë dhe të bindet gjithë bota për misionin e ri global, planetar, paqtues dhe harmonizues, që do të vijë nga mikroshteti i ri bektashian i Tiranës.

U gjet më në fund çelësi magjik i zgjidhjes së konflikteve që po lodhin OKB-në dhe botën, që nga Ukraina e deri në Gaza. Nuk ka ende informacion nga ATSH dhe mediat qeveritare për jehonën diplomatike tronditëse, që ka pasur të presidentët, kryeministrat dhe shefat e diplomacive të të gjitha vendeve ky projekt grandioz dhe i përbotshëm i shpallur me psalmën fetare të kryeministrit në OKB për zbritjen në tokë të një misionari të madh të paqes dhe të paj-

"SHTETI SOVRAN I URDHRI BECTASHI", NJË IDE GREKE, SERBE APO IZRAELITE?



timit global si mikroshteti i ri bektashian i kryeministrit të Shqipërisë.

Por duke lënë mënjanë ironitë dhe sarkazmat mediatike, projekti i ri i kryeministrit për krijimin e një mikroshteti bektashian brenda territorit të Shqipërisë, meriton të shihet përtej dhe më thellë sesa buzëqeshja tallëse, që shkakton në pamjen e parë projekti i tij grandioz politiko-fetar dhe botëror. Përtej megalomanisë tipike të kryeministrit, që vuan nga narcisizmi për grandomani dhe rol global, duhet parë kufijtë e Shqipërisë, në botë jo e jo, por as në rajon e as në trevat shqiptare.

Si diplomat dhe analist me përvojë

prej mbi 50 vite, e ndjej detyrë të tërheq vëmendjen se efektet e thella negative afatgjata shtrihen direkt në formatin dhe në ekzistencën e shtetit të Shqipërisë. Është hera e parë prej nga themelimi i shtetit të Shqipërisë në vitin 1912 që preket nga duar shqiptare sovraniteti dhe integriteti territorial i shtetit të Shqipërisë me krijimin e mikroshtetit sovran bektashian brenda territorit tonë.

Duhet menduar me gjakftohtësi se projektet e mëdha në kokën e udhëheqësve të vegjël të shteteve të vogla nuk dalin kot vetëm nga megalomania e autorëve. I kërkoni burimet e ideve në shtetet e huaja, që gëzojnë dashurinë fetare të kryeministrit. Mikroshteti

i ri bektashian duket një projekt, që ka qëllimet e veta përtejshqiptare, afatgjata diabolike.

Të dashur shqiptarë!

E ndjej detyrë t'ju njoftoj se kryeministri i Shqipërisë me këtë projekt ka nisur procesin historik të shkërmoqjes së shtetit të Shqipërisë. Deri tani Shqipëria është përplasur me grabitjet historike të territoreve të saj nga shtetet fqinjë si Serbia dhe Greqia. Por tani e tutje do të përplasat me procesin e ri historik të shkërmoqjes së saj nga Brenda, me vetë duart e shqiptarëve dhe konkretisht nga kryeministri i Shqipërisë. Kryeministri po sajton precedentin e krijimit të mikroshteteve të pakicave fetare dhe etnike brenda territorit të Shqipërisë dhe shkëputjet e njëpasnjëshme të territorit shtetëror me mikroshtete të tjera, sepse ekziston e drejta e trajtimit të barabartë të komuniteteve fetare. Kështu tani kanë të drejtë të krijojnë mikroshtetin e tyre fetar myslimanët sunitë në Shqipëri, të cilët sipas regjistrimit qeveritar të popullsisë në vitin 2023 janë dhjetë herë më shumë në numër sesa bektashijtë. Kanë të drejtë të kërkojnë tani mikroshtet të tyre katolikët, ortodoksët, etj.

Së dyti dhe më e rëndësishme, projekti i kryeministrit për mikroshtetin e ri bektashian u jep rast të artë shteteve fqinjë, që të hapin sirtaret e tyre të vjetra diplomatike e shtetërore dhe të ringjallin planet e krijimit të mikroshteteve greke, serbe, etj., brenda territorit të Shqipërisë. Pas derës pret Greqia, e cila mund ta përdorë precedentin e mikroshtetit bektashian si shembull për krijimin apo rikrijimin e një mikroshteti ortodoks grek me minoritarët e saj në Jugun e Shqipërisë. Skeletin e ka gati me asociacionin e komunave greke Finiq,

Dropull, bashkë me Himarën, për të të cilin kryeministri Rama i dha mundësinë kryeministrit grek Mico-taqis ta inuaguronte në dhjetor 2022 dhe kryeministri grek erdhi posaçërisht me helikopter ushtarak grek direkt në qendrat e asociacionit grek dhe kërkoi zyrtarisht vetëvendosjen greke të tyre. Tani Micotaqis ka gojën e lirë të kërkojë mikroshtetin grek të "Protokollit famëkeq të Korfuzit".

Pas derës pret Serbia, e cila i ka në sirtaret e saj planet e vjetra të krijimit të mikroshteteve serbe të tipit të "Republikës së Mirditës" të vitit 1921, që ishte tentativa serbe për shkatërrimin e shtetit shqiptar 9 vjet pas pavarësisë së Shqipërisë. Nuk e ka harruar Serbia. Mos harroni se në vitin 2011 deputetë të Parlamentit tonë nga Veriu krijuan "Lidhjen e Veriut" si skelet i ringjalljes së "Republikës së re të Mirditës".

Ndaj rrënjët e projektit grandioz të kryeministrit për shkërmoqjen e shtetit të Shqipërisë nuk është çudi të kenë ardhur në selinë e kryeministrit në Tiranë si ide greke apo serbe. Por mund të jenë edhe ide izraelite, si shprehje e interesit strategjik të Izraelit për të çarë lidhjet fetare midis Ballkanit dhe vendeve të Lindjes së Mesme dhe për të depërtuar vetë në Ballkan. Izraeli ka gjetur të Shqipëria shtetin më servil që mund të mendonte dhe e ka gjetur një shërbim pa para. Izraeli ka interes gjeopolitik të kundërvejtë bektashizmin me shumicat myslimane në Shqipëri dhe në Ballkan.

Shqipëria ka hyrë në një proces të ri të rrezikshëm të shkërmoqjes së saj si shtet. Nuk dihet se kush do ta zgjojë këtë popull të fjetur dhe të nënshtruar historikisht. Mbetet vetëm të themi: Zoti e shpëtoftë Shqipërinë!

POROSISNI BANNERIN PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website

BEN BLUSHI

Është e vështirë të kuptosh se ç'punë ka një shtet që sulmon një shtet tjetër, pasi ky i fundit po mbrohet nga një shtet i tretë. Irani sulmoi Izraelin sepse ushtria e këtij vendi cmontoi Hezbollahun që prej vitesh e sulmon nga Libani.

Kjo duket absurde. Është një lloj sikur Greqia të sulmojë Shqipërinë, sepse kjo ka neutralizuar një bandë që vepron në Mal të Zi dhe që aty hedh bomba mbi fshatrat e Shkodrës. Dhe kur Greqisë i thonë po ti cpunë ke, ajo të thotë, kjo bandë është e imja se është ortodokse. Këtë po bën dhe Irani. Megjithatë nuk është dhe aq e thjeshtë dhe absurde sa ç'duket.

Irani po mbron tre banda që i ka krijuar prej dhjetëra vitesh duke i furnizuar me para, me armë dhe kurajo. Këto banda që sulmojnë çdo ditë Izraelin janë Hamasi, Hezbollahu dhe Huthi në Jemen. Megjithëse nuk kanë pasur sukses ta shkatërrojnë Izraelin, ato kanë shkatërruar me sukses tre vendet ku veprojnë: Gazën, Libanin dhe Jemenin.

Prej lashtësisë Irani ka një aftësi të lartë vetëshkatërruese që mesa duket është ngjithëse.

Sulmi i djeshëm me më shumë se 200 raketa që nuk vrau asnjë shembje vetëm çatinë e një restoranti në gjithë territorin e Izraelit ishte një fishekzjarr mbi qiejt e mjegulluar të Gazës, Libanit dhe Jemenit për t'u dhënë këtyre bandave të rrënuara, një rreze drite. Ishte një shkrepse në tunelin ku ato jetojnë prej kohësh. Militanët e fshehur nëpër bodrumet e Gazës dhe Libanit mbrëmë nxorrën kokat dhe sytë ju shkëlqyen nga flaka që po derdhej mbi Izrael.

Por kur nata ra dhe shkëndijat u larguan, ata e ufurën prapë në bunker sepse e dinë se e nesërmja do jetë edhe më keq. Irani i përgjaku qiejt por nuk bëri dot asnjë dëm në tokë. Ky sulm i nisur në gjaknxehtësi dhe pa bërë asnjë llogari taktike do të bëjë pa dyshim efektin e kundërt, aq sa Irani duket sikur ka hedhur raketa kundër vetes së vet.

Dhe ja pse.

Së pari, sulmi ishte ushtarakisht aq i dobët sa që përveçse ekspozoi inferioritetin ushtarak të Iranit nuk pati asnjë vlerë në terren. Shumica e raketave nuk ra në tokën e Izraelit por u shkatërruan në ajër. Artileria e rëndë e Iranit nuk gjeti asnjë shënjestër të rëndësishme. Është një lloj sikur ti gjuash me automatik një xhami që nuk thyhet. Nëse nuk ndrron dot xhamin duhet të ndërrosh automatikun, por mesa duket Irani kaq mundësi ka. Izraeli është poligoni i dështimit ushtarak të tij. Pak ditë më vonë Izraeli do e sulmojë edhe ai Iranin dhe dëmi që mund të shkaktojë, do duket edhe më i madh pas kësaj grope ushtarake.



Së dyti, pas këtij sulmi, hyrja e ushtrisë izraelite në Liban nuk do të ndalet pasi shkatërrimi përfundimtar i Hezbollahut të plagosur është edhe më i justifikuar. Pa Hezbollahun Irani është më i dobët, sic është më i dobët sot edhe pa Hamasin. Militanët e frikësuar të Hezbollahut të shpërdarë nëpër bunkerë në Liban do kapen, do eliminohen ose do zhduken, por derisa kjo të ndodhë plotësisht, për fat të keq miliona njerëz do kthehen në refugjatë siç po ndodh këto ditë kudo në Liban.

Së treti, Libani po kthehet në një vend pothuajse të pajetueshëm dhe kjo situatë do vazhdojë gjatë. Ky vend që dikur ishte perla e Lindjes së Mesme, ishte i dobësuar nga krizat e brendshme financiare dhe politike prej vitesh dhe goditja që po merr nga Izraeli, rrezikon ta nxjerrë totalisht jashtë funksionit për disa vjet. Një vend i padministrueshëm, me një ekonomi të rrënuar dhe me një ushtri që nuk ekziston, do të thotë një aleat më pak për Iranin që u nis të shkatërrojë një armik, por po shkatërron miqtë e vet.

VETËVRRASJA E IRANIT

Së katërti, ky konflikt që ka një vit që nuk mbaron dhe që filloi me masakrën e 7 tetorit mbi qytetarët civilë të Izraelit, e ka vënë seriozisht në diskutim shtetin palestinez apo tëo state solution, pra zgjidhjen e dy shteteve. Shteti palestinez i penguar prej disa dekadash nga Izraeli, u plagos për vdekje nga Hamasi një vit më parë dhe pothuajse po vritet nga Iranitani. As vetë partitë palestineze nuk kanë më fuqi dhe aleatë ndërkombëtarë për të mbrojtur shtetin e tyre që sot duket sikur ka humbur në shkretëtirë. Ndoshta kjo mundësi e pashfrytëzuar mirë, ka përfunduar përgjithmonë, sepse kushdo që vjen në pushtet në Izrael nuk do pranonte të jepte më shumë të drejta palestinezëve pas ngjarjeve të vitit të fundit. Gaza e shkatërruar mund të administrohet nga Perëndimi por jo më nga Hamasi. Hamasi është një kafshë e ngordhur. Por plagët e kthetrave të tij mbi lëkurën e Izraelit nuk mbyllen dot vetëm me ilace por edhe me barut sic edhe po ndodh. Konflikti në Lindjen e Mesme, tani po e ushqen urrejtja e futur në mes të sanduicit të kalkulimeve politike të Izraelit dhe Amerikës

Së pesti, mbështetja e lëkundur e Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj Izraelit do të forcohet. Të gjithë ata që e kanë kritikuar Izraelin për ndërhyrjet e dhunshme me pasoja civile në Gaza dhe Liban do të tërhiqen pak. Nga cdo cep i botës që ta shohësh, Irani duket më i zi se Izraeli, sepse i pari po sulmon, kurse i dyti po mbrohet. Irani po sulmon një shtet tjetër duke qenë vetë i pasulmuar prej tij. Kjo do ta izolojë Iranin dhe më shumë dhe ndoshta do krijojë efektin që të gjithë presin prej dekadash që dicka të ndryshpë nga brenda. Por edhe nëse kjo nuk ndodh, pra nëse rregjimi i Iranit nuk bije nga brenda, sic kanë shpresuar liberalët kudo në perëndim, ndoshta Irani do rrëzohet nga jashtë. Një sulm i plotë i Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara kundër Iranit nuk është asnjëherë i përjashtuar, pas ngjarjes së fundit. Ndoshta do kishte ndodhur nëse zgjedhjet në SHBA nuk do ta kishin penguar.

Së gjashti, ky sulm do ta ndryshojë politikën e Amerikës ndaj Iranit duke patur dhe ndikim në zgjedhje cka ka qenë prej kohësh një nga qëllimet

kryesore të Netanyahu. Netanyahu ka venë bastin më të fortë në planet për rezultatin e këtyre zgjedhjeve. Edhe në ditët më të vështira të Izraelit ai ka refuzuar me dinakëri kërkesat e Presidentit Biden për armëpushim në Gaza. Netanyahu e dinte që armëpushimi do shitej si fitore në Amerikë dhe prandaj e ka përdorur Gazën si një votë kundër administratës së butë të demokratëve.

Është e qartë që Netanyahu po pret kthimin e Donald Trump në pushtet me shpresën se ai do ta ndihmojë t'i japë fund regjimit të Iranit. Dhe pavarësisht se Trump është i paparashkueshëm kjo nuk përjashtohet. Irani pra ka gabuar dy herë sepse duke rënë në kurthin e Izraelit, ka forcuar krahun më agresiv kundër tij në zgjedhjet amerikane. Me sulmin e fundit Irani po ndihmon zgjedhjen e armiqve të vet. Qëllimi kryesor i Izraelit është të tërheqë Amerikën në luftën përfundimtare kundër Iranit dhe këtë po e arrin me ndihmën bujare të vetë Iranit.

Së shtati, vendet arabe sunite në rajon që nga Arabia Saudite, Jordania, Egjipti etj, të gjitha do rrisin shkallën e bashkëpunimit kundër Iranit. Ato e dinë se Irani i rrezikon më shumë se Izraeli. Izraeli do të nënshtrojë Gazën, kurse Irani do të nënshtrojë rajonin. Irani i ngjan një banditi që pretendon se ka armë bërthamore dhe sa herë del nëpër lagje të gjithë konshinjët duhet të fshihen.

Çështja palestineze do ishte shumë më e zgjidhshme nëse Irani do ishte një vend më miqësor dhe demokratik. Sikur Gaza të ishte një vend normal ku bëheshin zgjedhje dhe ku partitë ndryshohen me vota s'do kishte Hamas dhe nuk do kishte dhunë. Atëherë Izraeli do ishte në vështirësi dhe zgjidhja me dy shtete do ishte një e drejtë e fituar me rrugë politike dhe e mbështetur nga gjithë Perëndimi. Por Irani është përgjegjës direkt për favorizimin e linjës së ashpër duke vrarë demokracinë në Gaza dhe duke forcuar banditët lokalë të Hamasit të cilët para se të vinin në pushtet, eliminuan gjithë liberarët palestinezë. Edhe për shkak se mbjell vetëm autoritarizëm dhe vret cdo filiz demokracije, Irani ka cdo ditë e më pak aleatë dhe sulmi i fundit duket më shumë si një vetëvrasje e paralajmëruar. Si një bombë e shpërthyer në xhep. Prandaj fishekzjarret që Irani hodhi mbrëmë mbi qiejt e botës janë një lajmërim publik se vetëvrasja filloi dhe nuk do ndalet.

SONILA MECO

Në maloren drejt lagjes ku banoj ngjitej me vështirësi një grua thatime, veshur trashë për motin e ngrohtë të ditës. Ecte ngadalë dhe ndërsa tërhiqte çizmet e mëdha lëshonte zëshëm ahtin e një mundimi fizik, që të këpuste shpirtin. Zbrisja përkundër dhe ndala duke e vëzhguar tekta më kaloi përbri. As moshë nuk i përcaktoja dot, por s'kish më rëndësi kjo.

Vuajtja i ulërinte e çante përmes indiferencës së kalimtarëve, të hutuar, shqetësuar e nxituar edhe ata. S' durova, e arrita shpejt, i kapa krahun dhe i kërkova të më priste sa të merrja makinën aty pranë, parkuar me bllokazh hapur e ta shoqëroja deri lart (malorja bëhej edhe më e papërbalueshme për të me arritjen në hyrje të rezidencës).

Më priti ulur në bordurë, hyri me vështirësi dhe ngjeshi pas qafe shallin e trashë.

E pyeta nëse kishte ftohtë e mu gjegj me një breshëri diagnozash. Kish zë të bukur, paksa të gërvishtur, por të ngrohtë e të paqtë. Punonte sanitare në dy vila në një rezidencë luksoze. Autobusi që vonuar e nuk mund të humbiste kohë më shumë. Kish tre fëmijë, më e madhja maturante. Donte ta shkollonte me çdo kusht, të mbaronte universitetin për mjekësi, ëndrra e të dyjave, nënë e bijë. E divorcuar, kujdesej e vetme për fëmijët, më i vogli 14 vjeç. Donte t'u sigurononte shkollën e lartë të treve. Me fjalët e saj më pohoi se punonte si "kafshë", veç të shihte fëmijët të shkolluar. Pamundësia për "ta ndritur vetë", siç më tregoi për veten, e kish bërë robinjë të ëndrrave për fëmijët dhe veç edukimin shihte si gurkycin magjik të daljes nga mizerja e vet, të lumturisë së krijesave të saj. Punonte mbi 12 orë në ditë, edhe fundjavave.

Mu dhimbs, por edhe e adhurova për mençurinë, që nuk ia kish bërë kurban "shpullave" të jetës. Sakrificat sublimë jo thjesht për bukën e gojës, as



për "lilotari" fati me dhëndurë për të bijat, por edukimin e tyre i bënin akuzë tmerrit të lajmeve mbi çeljen e universiteteve. As nuk i hyra atij diskutimi, doja ta përgëzoja e t'i tregojta ç' lartësi kish arritur ai trup thaim e i kërrusur në sytë e mi, pa mbushur ende të 40-at, e vetme, e sfilitur, por jo për mbijetesë, por për t'u dhënë edukim e formim tre fëmijëve të saj.

Sesi u ndjeva pasi zbriti me shkulte dhimbjesh osteoporozë e herniesh mund ta dijë veç roja i rezidencës, që pa se si u përkula mbi timon e u shkrehu në lot. Jo për gruan e rraskapitur, ajo ish e ndriçuar në terrin, që ka kapluar njerëzit e dorëzuar shkretëtirës kulturore e shpirtërore. Dënësia erdh prej katandisjes e dënimit më të ndyrë, që mund t'i bësh një kombi: shkatërrimin e arsimit në të gjitha nivelet, mundësive të edukimit dhe zhvillimit profesional,

kërkimit shkencor, formimit dhe "furnizimit" të tregut të punës, ekonomisë, institucioneve me njerëz të kualifikuar, specializuar, ndriçuar dijesh e teknikash.

A i ndoqët lajmet dje? A i patë studentët në protestë? Po mbyllen degë universitetesh, s'ka më studentë, po tejkalohej numri i tyre nga pedagogë mbaruar institucione arsimore gjithnjë e më të dobta, me grada shkencore zhytur plagjaturash, pa botime në revista shkencore, pa studime. Kontrata Sociale është "grisur" me tërëllimë nga shteti para syve të prindërve e të rinjve në pjesën e saj më të gjallë: aksesin në edukim cilësor. Arsimi po dështon dhe po na dështon si shoqëri me aprovimin diabolik të autoritetit shtetëror. Ky dështim i drejtuar e assesi thjesht nga paaftësia po prodhon shoqëri të varur e injorante, elektorat të marrë peng, autoritarizëm, ekonomi të shkatërruar,

kriminalitet të sofistikuar, pabarazi vrastare, meritokraci të dërrmuar, cikël varfërie e marginalizimi, tkurrje kapitali njerëzor, emigracion masiv, diplomaci qesharake.

Do ta shkatërron një komb në shekullin e 21-të? S'ka nevojë as për raketa, as armë atomike. Mjafton ulja e cilësisë së arsimit e edukimit, krijë kurrikula skandaloze, realizo testimë fiktive, zhbë ndërgjegjen morale, kap median, helmo kulturën e artin e mirfilltë dhe vendos si mjet shkëmbimi favoresh korrupsionin në çdo ndërveprim qelizor shoqëror. Profesionistë në pozicione jetike e sigurie, që arrijnë pozicione drejtuese nëpërmjet manipulimeve, korrupsionit, afërsisë me pushtetin. Pa ide, pa formim, pa studim, pa djersitur notën, pa investuar kohë e mund, pa ndërmarrë itinerarin përkushtues drejt ndriçimit të plotë të mendjes e t'i lejojsh të kryejnë operacione, t'u shër-

bejnë njerëzve, të ndërtojnë rrugë e ura, të drejtojnë financa, të japin drejtësi, të edukojnë breza, të kryejnë hetime e parandalojnë krime, të informojnë publikun, të udhëheqin një vend, të bëhen prindër...

Si t'ja thojta këto gruas së tkurrur si mosozot edhe aq, nga sakrificat ekstreme për të siguruar të ardhmen më të mirë se e saja për tre fëmijët e vet... por si ka mundësi të heshtin prindër të tjerë, më të kultivuar e mundur karshi kësaj gjëme?!

Po për çfarë drejtin vlen të marrësh ende frymë kur lejon të të shkatërronjë arsyen madhore të përmbushjes njerëzore? Si mundet të na zërë gjumi si prindër, ndërsa lejojmë të na dënojnë të ardhmen e fëmijëve kësajsoj? Po për çfarë punove, u sfilite, u rropate e durove o njeri, që t'a dorëzosh kaq lehtë arsyen e krijesave të tua, hisen e shpirtit, vendin ku dhe gjithçka për t'u kujtuar me dinjitet për të veneruar "idhuj" me pushtete absolute e influencera instagrami?

Ah moj Bardhë (emri i bënte drejtësi asaj qenieje qelibar), nuk t'i thashë të gjitha këto dhe ndoshta bëra gabim!

Sepse të nisa sërisht t'u shërbesh me devotshmëri atyre, që fëmijët i sistemojnë në çdo kohë se janë nën çadrën e pushtetit, tekta u bëjnë gjëmën fëmijëve të tu e shumë të tjerëve në luftën për t'i rezistuar së keqes, që na ka zënë.

Fola tani e publikisht o grua e mirë edhe për ty e të ngjashëm të tjerë, që nuk kanë asnjë kontratë me fatin e tyre veç dinjitetit! Në më lexofsh, dije se je "idhulli" im dhe se shpagimi i drobitjes tënde do të shpërblehet me të vetmin investim, që askush nuk mund t'ua shkulë fëmijëve tanë: edukimin. Në emër të tij e për të ia vlen çdo betejë me të keqen.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



1935/ "SHQIPËRIA, VENDI I BURRAVE TË BUKUR", INTERVISTA ME POETIN ANONIM SHQIPTAR TË HUMBUR NËPËR KAFENETË E HAVANËS

“Puerto Rico Ilustrado” ka botuar, me 2 nëntor 1935, një intervistë asokohe me një poet anonim shiptar të humbur nëpër kafenetë e Havanës (Kubë) rreth situatës së brendshme të vendit tonë, të cilën, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Vendi i burrave të bukur

Nga MAX

Revolucion ! Një tjetër revolucion ! Dhe, pastaj, më shumë revolucione ...

Si një ndërmjetësim në konfliktin italo-abisinian, një herë dy ditë, pastaj tre dhe në fund disa ditë të tjera, Shqipëria ka fituar nderin e faqeve të para të gazetave, përmes një revolucioni më shumë, ku pati edhe vdekjen e një gjenerali, vartës të Mbretit Zog I... Më në fund, rendi u rivendos dhe bashkë me të, edhe një herë, heshtja mbi këtë vend të komplikuar.

Çfarë është Shqipëria për botën ? Shqipëria gjendet në rrugicën e Ballkanit. Duke iu kthyer enciklopedisë, ne e dimë se është një vend asgjë më pak se i egër. Gratë mbulojnë fytyrat e tyre, burrat kanë mustaqe të mëdha dhe pushkë që i ndezin me strall. E gjithë kjo, për llogari të enciklopedisë. Por, më interesantja është se këtë herë enciklopedia tregon të vërtetën.

Muajin e kaluar — një lajm që tashmë na ka rrëshqitur nga duart, por që ende shërben për të folur për diçka të pazakontë — Shqipëria u zhyt plotësisht në redaksitë e gazetave, me bujë të madhe, pa arritur të gjejnë dikë që të sqaronte shtigjet misterioze që motivuan revoltën. Më në fund, në një nga ato qoshet e Havanës, gjetëm një tip, origjinën e të cilit e kishim dyshuar prej kohësh dhe që besuam se mund të ishte shqiptar. E gjetëm.

Siç për ta përshkruar, ai mban një zinxhir të frikshëm në bark, në fund të të cilit duhet të ketë një orë të madhe, flokë të gjatë ngjyrë gështenj, etj. Pi shpesh. Ai është një poet. Ai ka qenë mësues në Havanë, madje besojmë se është mësues i frëngjishtes. Ne dinim edhe këtë detaj : Njeriu ynë e kishte ushtruar mësimin e tij në Shqipëri dhe jo më pak se në oborr, në oborin që ruan pushkët e tmerrshme me strall. Kur e gjetëm ai ishte përballë kafesë së tij që po avullonte :

— Miq : jeta është mizore, — na tha — por kjo ndodh. Unë shpresoj të harroj.

Na bëri përshtypje, sepse këto fraza janë të denja për epokën romantike. Para nesh pamjet u gjallëruan sërish dhe pseudoshqiptari tha :

— Zbarkova në Durrës, një nga portet e Shqipërisë, në të njëjtin vend ku vite më parë mendova të zbarkoja një nga Domecq-të, — Aladro Domecq Kas-



trioti —, prodhues të konjakut të njohur botërisht, i cili si pasardhës i një dinastie të famshme shqiptare, aspironte për fronin që gëzon sot Zogu I. Durrësi është afër Tiranës, kryeqytetit të vendit, ashtu si Pireu me Athinën, kryeqytetin e Greqisë.

— Ne nuk e kemi idenë se çfarë është Shqipëria, ia bëjmë të ditur.

— Epo, dëgjoni diçka për atë vend : “Zbrita me këmbët e mia dhe mora rrugën e menjëhershme për në Tiranë. Një shërbëtor i improvizuar, i veshur me një çallmë, papritur filloi të dridhej dhe iku. Shumë shpejt erdhi një tip i rrethuar nga roje. Më pas mora vesh se nuk ka hekurudhë për në kryeqytet. Nuk e besoni se ky vend i çuditshëm është në Evropë ? Epo ja ku është ! Ai gjendet në anën tjetër të Adriatikut, pikërisht përballë Italisë. Kufijtë e tij kufizohen me Jugosllavinë dhe Greqinë. Është vendi më perëndimor i kombeve të Evropës Qendrore. Ka një shtrirje dhe formë gjeografike të ngjashme me Portugalinë.

A po më dëgjoni ? Por, pa hekurudhë.

“Në Durrës, më këshilluan të merrja një makinë. Janë vetëm 40 kilometra”.

— Ja ku është Tirana, — bërtiti papritmas shoferi.

“Por, nuk pashë asgjë; vetëm disa baraka, copa hekuri, copa teli nga gardhe me tela, fusha në të cilat ushtarë të shumtë të hollë, të veshur keq dhe zbathur, bënin ushtrime...

Pastaj u shfaqën disa shtëpi të bardha njëkatëshe, rrugë fshatrash modeste, ku bari ngjitej nëpër mure. Shoferi u kthye dhe tha :

— Dhoma e Deputetëve! (Parlamenti)

“Pak më tutje, valëvitej një banderolë prej pelhure të bardhë, brenda së cilës ishte varur një burrë”.

— Një hajdut, — vazhdoi shoferi. Dhe shtoi : ose një ministër i shkarkuar.

“Shoferi më ndaloi përballë të vetmit hotel të mundshëm të quajtur Internacional. Kur e pyeta për çmimin e udhëtimit, ai m’u përgjigj me shumë thjeshtësi dhe në frëngjisht :

— Një Napoleon !

Njësia monetare shqiptare quhet “Lek”. Por paratë që qarkullojnë janë ato të vitit 1810, Napoleoni, pra një Luigj floriri. Dhe pashë të dilte nga duart e këtyre myslimanëve, që nuk e dinë kush është Napoleoni apo Franca, çfarë nuk gjendet më në vetë Parisin : Luigjin e shëndoshë, të ndritshëm, mrekullibërës : Napoleoni i artë.

“Në hotelin Internacional, katër anglezë të Legatës po luanin “bridge”. Tre italianë, po nga Legata, po debatonin për poezinë. Një francez nga Legata bindi një shërbëtor që donte të sulmonte një francez tjetër se ai ishte një çirak joshës. Kjo është, pak a shumë, e vërteta. Dhe kjo është Shqipëria!”

“Të nesërmen dhe ditët në vijim, nuk bëra gjë tjetër veçse shëtisja dhe dëgjoja.”

“Mbreti i këtij vendi komik, Zogu, është 36 vjeç. Është i bukur, beqar dhe melankolik. Kanë kaluar dhjetë vjet që kur ai u ngjit në fron, si pasojë e trazirave që pasuan luftën dhe diktaturës së përmbytur të Princ Vidit. Ai ka një nënë, e cila është gjithashtu një mbretëreshë dhe jeton si një myslimane (Kur është bërë ky rrëfim, nëna e Ahmet Zogut ka pas ndërruar jetë), e tërhequr në apartamentet e saj, e cila pret vizitorë të privilegjuar të mbështetur mbi një grumbull jastëkësh dhe rrobash mëndafshi, me dorën e mbështetur në gjunjët e saj, duke pirë cigare me aromë të veçantë, tymi i të cilit fryn në fytyrat e vizitorëve të saj. Zogu gjithashtu ka gjashtë motra, nga 20 deri në 30 vjeç, të gjitha të ngjashme sikur të ishin binjake; Ato jetojnë së bashku, si të disiplinuar. Në rrugë, në ceremoni, ato vishen sipas modës myslimane, me vellon (ferexhenë) e pashmangshme. Por në privatësinë e atij pallati mbretëror që i ngjan shumë një kazinoje, ato vishen si Paquin ose Patou, duke mbërritur përmes një hyrje sekrete. Në verë, oborri zhvendoset në Durrës dhe shkojnë në pyje si një koloni pushuesish.”

... Pikërisht këtu i erdhi fatkeqësia këtij miku, i diplomuar për letërsi, poet shqiptar “honoris causa”. Lexoni siç na e shpjegon vetë ai :

— Unë rashë në dashuri me gjashtë motrat e mbretit në të njëjtën kohë dhe u desh të largohesha. Zogu është një mbret i mirë. Ai është i vendosur për ta bërë Shqipërinë një komb. Ai është sentimental dhe autoritar; dhe problemi politik i Shqipërisë është brenda këtyre dy fjalëve.

“Sentimental dhe beqar, aty ndodhet pylli i të gjitha aventurave. Ai ka kaluar një kohë shumë të mirë me balerinat e Folies Bergere. Autoritar, ai ka vendosur diktaturën me ndihmën dhe modelin e Italisë. Ushtria e tij ka instruktorë italianë. Pasuria e tij kontrollon nga Italia, dhe për Romën, megjithatë, ai është një vasal që duhet vëzhguar”

“Dhe këtu qëndron sekreti i revoltës së kaluar, të cilën asnjë agjenci kabllore nuk e ka publikuar : është inkurajuar nga babai, i një të preferuar (vajze), të shkarkuar nga Zogu. Zogu, personazh piktoresk dhe plot ngjyra i Evropës moderne, udhëheqësi ngurrues i një kombi të ish të poshtërish, baba i një oborri operetash, ende arriti të ruante fronin e tij.

— Më besoni : është kënaqësi të jetosh në Shqipëri.

Miku ynë shqiptar, një poet i humbur nëpër kafenetë e Havanës, ka përfunduar me këto fjalë. Nuk mund të merrim asgjë tjetër prej tij. Nga ana tjetër, nuk ka nevojë të dimë më shumë : lexuesit tanë kanë marrë me atë që u tha, një mësim të mirë psikopolitiko-gjeografik për Shqipërinë.

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKESIN E KOMPANISË TUAJ



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

VETON SURROI

HAPAT E LENINIT NË TIRANË

Debati rreth besimeve me “Vatikanin bektashi” dhe burgosja e deputetit Salianji si ndëshkim i fjalës së lirë janë probleme të reja e krejtësisht të panevojshme për një shtet që me probleme të mëdha, si krimi i organizuar, do të fillojë negociatat e anëtarësimit në BE

1.

Shqipëria mund të parafrazojë titullin e librit të librit të V.I. Lenin nga fillimi i shekullit XX “Një hap para, dy hapa prapa: kriza në partinë tonë”, me zëvendësim të fjalës “parti” me atë “shtet”. Pra, disa ditët e kaluara dhe të ardhme mund të tregojnë një çrregullim të funksionimit të shtetit, mbase edhe si paralajmërim të pakëndshëm për të ardhmën.

Të fillojmë nga hapi para.

Shqipëria në mesin e muaj tetor pritet të fillojë më në fund negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Vendi është mbajtur për një dhjetëvjetësh në status kandidati për anëtarësim dhe përgjatë këtyre dhjetë vjetëve nuk kishte ndonjë arsye që lidhej me Shqipërinë e që do të duhej të pengonte hapjen e kapitujve negociatorë. Shqipëria ishte mbajtur peng lidhur me çështjeve identitare të lindura nga zhbërja e ish Jugosllavisë, duke qenë tashmë pjesë e Klubit të Ballkanit Perëndimor (në shoqëri me 5 shtetet të dala nga ish Jugosllavia).

Për dhjetë vjet vendi pagoi tagrin e problemeve identitare mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë e së fundmi edhe Bullgarisë, relacionit mes Kosovës dhe Serbisë, paralizës kushtetuese të Bosnje e Hercegovinës dhe procesit të kontestimit të Malit të Zi si komb e shtet.

Nga mesi i tetorit nuk do të jetë më me rëndësi për Shqipërinë në marrëdhëniet me BE-në se çfarë shkruan në librat maqedonas për heronjtë revolucionarë bullgarë, si mund të duket Bashkësia e komunave serbe në Kosovë, pse Dodiku mund të shpallë të pavlefshme përmendjen e gjenocidit të Srebrenicës apo çështja e ekzistencës të Kishës ortodokse malazeze të njohur nga Patrikana e Stambollit. I tërë ky konglomerat problemesh ishte aty çdoherë kur debatohej për integrimin e Ballkanit Perëndimor dhe disi me nënkuptueshmëri si pjesë e regionit futej edhe Shqipëria.

Në momentin e hapjes së “clusterit” të parë, Shqipëria do të negociojë në bazë të meritave të veta.



2.

Në këtë pikë, ende pa u hapur kapitujt e rëndë për Shqipërinë- siç është sundimi i ligjit- vendi kandidoi probleme që janë indikatorë seriozë për shtetin.

Kryeministri Rama ofroi argumente serioze për kritikë natyrës së shtetit kur doli me iniciativën e tij për “Vatikanin mysliman”, gjegjësisht “sovrانيتin bektashi” brenda territorit të Shqipërisë. Kryeministri shkeli me të dyja këmbët rregullin bazë kushtetues me të cilin mund të krenohet Shqipëria, madje ballëllartë pothuajse gjithandej Evropës, se “shteti është asnjans në çështjet e besimit”. Kryeministri shpjegoi se “ndryshe nga komunitetet e tjera, të cilat kanë avantazhin e natyrshëm të përkatësisë në komunitete shumë të mëdha me shtirje globale - pra kanë edhe mundësi të mëdha mbështetjeje të pandërprerë në rrugën e tyre - komuniteti bektashi është si të thuash “jetim” në këtë këndvështrim. Prandaj afërmendsh që ngritja e statusit të Kryegjyshitës Botërore në Shqipëri në nivelin e një entiteti sovran, jo vetëm do të ulte ndjeshëm kërcënimin real të tkurrjes së atij komuniteti deri në tretje në harkun e disa dekadave, po do të garantonte një vazhdimësi të qëndrueshme të ekzistencës së tij për breza të tërë”. Kështu, ai ndërhyri në fushën e cila nuk i lejohet, asaj të besimeve. Sepse shteti laik ndonëse fillimisht i ndërtuar për ta mbrojtur shtetin prej religjionit ka edhe obligimin e mbrojtjes të religjionit nga shteti.

Për më tepër, kryeministri i vendit po e hap një çështje tashmë të rregulluar juridikisht e praktikisht. Shqipëria ka njohur subjektivitetin dhe pluralizmin e krishterë e islamik- Këshilli i Ministrave dhe katër bashkësitë fetare (Komuniteti Mysliman, Kisha Autoqefale Ortodokse, Kryegjyshitë Bektashi, Vëllazëria ungjillore) kanë nënshkruar Marrëveshje e cila i shndërron ato në subjekte juridike. Këtyre u është shtuar edhe Marrëveshja Shtetërore me Vatikanin që rregullon edhe materien e subjektivitetit të Kishës katolike në vend.

Nga aspekti juridik e praktik nuk ka gjë që rrezikon besimin në vend. Gjegjësisht, nuk ka gjë që rrezikon bashkësitë fetare pos ndërhyrjes krejtësisht të panevojshme politike të njeriut më të fuqishëm politik në Shqipëri. Pas iniciativës së tij, reagimi i parë që i komunitetit mysliman i cili pos që u ndie i ofenduar për vlerësimet për islamin nga ana e kryeministrit, u ofrua po ashtu të mohojë subjektivitetin bektashi duke u ofruar si ombrella e “të gjitha tarikatëve”.

3.

Kryeministri në ditët në vijim po ashtu mori një anë të gabuar në një çështje tejet të ndjeshme të lirive politike me burgosjen e prijësit të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Ervin Salianji.

Salianji po vuan që nga kjo javë dënimin e plotfuqishëm me burg njëvjeçar për diçka që në çdo vend evropian, përfshirë edhe Shqipërinë,

duhet të jetë e drejtë e shprehjes së lirë jo më të anëtarit të Kuvendit, por edhe të çdo qytetari të rëndomtë. Kjo e drejtë e shprehjes së lirë nënkupton edhe të drejtën për të gabuar, sepse e drejta për të gabuar është thelbi i debatit demokratik. Pagabueshmëria është e kundërta e demokracisë andaj anëtarët e Parlatenteve flasin pa drujtje se mos eventualisht po gabojnë e po futen në burg. Korrigjimi i gabimeve në të shprehur bëhet në Parlament dhe në zgjedhje.

Duke shfrytëzuar të drejtën e tij për të folur, qoftë edhe gabimisht, Salianji nxori disa akuza publike për një ministër të Qeverisë Rama dhe vëllait të tij i cili kishte qenë i dënuar për krime. Këto akuza dërguar “urbi et orbi”, pra askujt konkretisht, janë konstatuar si të pamjaftueshme për iniciat të procedurave penale. Në një rend demokratik, çështja do të mbyllej me kaq, dhe në rastin më të keq, Salianji do të paguante tagrin politik për një akuzë e cila qe e pamjaftueshme për prokurorinë.

Por dy gjykata, njëra e shkallës së parë dhe tjetra e apelit e dërguan në burg për një vepër të paqenë. Salianji u dënua për “kallëzim të rremë” që është vepër penale e cila konsumohet juridikisht kur personi paraqet gojarisht apo me shkrim denoncimin e tij për një vepër penale pranë organeve të hetimit, polici e prokurori dhe ai denoncim del të jetë qëllimisht i pavërtetë. Salianji këtë veprim nuk e ka bërë dhe tash është në burg si i dënuari i parë për “delikt verbal” në Shqipërinë post-komuniste e cila po i hap negociatat e anëtarësimit në BE.

Kryeministri Rama, i njohur në filllet e aktivizmit të tij publik si njëra prej figurave më të spikatura liberale të angazhuara për liri të shprehjes, do të bënte mirë të mbante anën e duhur, atë të mbrojtjes së të drejtës së shprehjes të kundërshtarëve të tij politik. Jo vetëm që është vlerë morale, por edhe praktike, për një vend me aspirata demokratike si Shqipëria së cilës i nevojitet opozita.


Për më tepër, Kryeministri Rama ka mundësi të përdorimit të një precedenti juridik në mbrojtje të të drejtës së zotit Salianji. Një deputet tjetër i opozitës, Gazment Bardhi, akuzoi vëllanë e kryeministrit si njeri të përfshirë në trafik droge. Vëllai i kryeministrit paraqiti deklarinim mediatik të deputetit Bardhi në Prokurori me akuzë për “kallëzim të rremë”, por Prokuroria hodhi poshtë këtë denoncim, sepse fjalët e deputetit Bardhi ishin të shprehura në medie e jo të deponuara në Prokurori. Saktësisht sikur në rastin Salianji.

4.

Shqipëria, e çliuar përtej problemeve identitare të fqinjëve të vet, po hyn me të shpejtë në hapjen e problemeve shtesë. Sikur të mos mjaftonte “elefanti në dhomë”-prania jashtëproporcionale krahasuar me vendet evropiane të krimit të organizuar në ekonomi dhe funksionimin institucional të vendit - krijimi i problemeve të reja nga ato deri më dje inekzistente si çështja e besimeve apo e shprehjes së lirë është oguri më i keq për ardhmërinë e negociatave evropiane të vendit.koha

NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Pulse
- Temperature
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose




Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059





Dotech
website



**A JENI
REGJISTRUAR
NË GOOGLE?**

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Ne mund t'iu ndihmojme edhe me:

-Business Cards

-Logos

-Banners

-Posters

-Flyers

-Video Marketing

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona

CONTACT US

Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London E13 8HT